



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 45
Prishtinë, më 20 dhe 23 janar 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 20 DHE 23 JANAR 2012**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 95 deputetë.

Në filim të mbledhjes për fjalë u paraqit kryetari i GP të PDK-së, Adem Grabovci.

Adem Grabovci tha se duke u mbështetur në nenin 40 dhe 52 (2) të Rregullores së Kuvendit, GP i PDK-së parashtrroi mocion me rekomandime lidhur me zhvillimin e ngjarjeve të 14 janarit 2012. Ai kërkoi që ky mocion të radhitet si pikë e veçantë e rendit të ditës.

Kryetari kërkoi deklarimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me mocionin e GP të PDK-së.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, tha se përkrah kërkesën e GP të PDK-së për debat lidhur me këtë çështje, ndërsa lidhur me rekomandimet e paraqitura nga propozuesi theksoi se ato duhet të nxirren në fund të debatit.

Visar Ymeri, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se çështje urgjente e konsideron politizimin e Policisë së Kosovës, në ngjarjet e 14 janarit të këtij viti, në protestën e organizuar nga lëvizja “Vetëvendosje”.

Në lidhje me rekomandimet e paraqitura nga propozuesi, ai tha se ato nxirren në fund të debatit.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, tha se nuk e mbështesin kërkesën e GP të PDK-së për debat lidhur me këtë çështje, ngase paraprakisht asnjë grup parlamentar nuk është konsultuar për diçka të tillë.

Myzejene Selmani, në emër të GP të Koalicionit Kosova e Re, tha se mbështet kërkesën e GP të PDK-së për debat lidhur me këtë çështje, ndërsa rekomandimet duhet të formulohen si rezultat i debatit që do të zhvillohet.

Sasha Milosavljeviç, në emër të GP SLS, tha se mbështet kërkesën e GP të PDK-së për debat lidhur me këtë çështje.

Duda Balje, në emër të GP “6+”, tha se mbështet kërkesën e GP të PDK-së për debat lidhur me këtë çështje.

Lidhur me mocionin e GP të PDK-së diskutoi edhe nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

Pas këtyre deklarimeve, kryetari hodhi në votim kërkesën e GP të PDK-së, për debat lidhur me zhvillimet e ngjarjeve të 14 janarit 2012. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 53,
Kundër----- 24,
Abstenime----- 10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi mocionin e GP të PDK-së për të debatuar në mbledhjen e sotme lidhur me zhvillimin e ngjarjeve të 14 janarit 2012.

Visar Ymeri, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, propozoi që Kuvendi në mbledhjen e sotme të debatojë lidhur me politizimin e Policisë së Kosovës, në ngjarjet e 14 janarit 2012.

Kryetari hodhi në votim kërkesën e GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 21,
Kundër----- 53,
Abstenime----- 9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk miratoi propozimin e GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës, për mandat të ri,

5. Ratifikimi i Marrëveshjes financiare në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim KfW, për përmirësimin e sistemeve të ngrohjes qendrore,
6. Debat lidhur me Mocionin e GP të PDK-së për ngjarjet e 14 janarit 2012,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë,
9. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullimin e tokës,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Policinë.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën: në emër të GP të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Rexhep Selimi, në emër të GP të AAK-së, Ardian Gjini, si dhe deputetët: Blerta Deliu-Kodra, Hykmete Bajrami, Afrim Kasolli, Zenun Pajaziti, Donika Kadaj-Bujupi, kryeministri Hashim Thaçi, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, ministri Ramë Buja dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Alma Lama, parashtoi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, në lidhje me veprimet që ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës për kthimin e kursimeve të Trustit Pensional në Kosovë.

Kryeministri Hashim Thaçi e kishte autorizuar ministrin Bedri Hamza për t’u përgjigjur në pyetjen e deputetes Alma Lama.

Bedri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama

Deputetja Alma Lama, parashtoi pyetje për ministrin Bjaram Rexhepi, në lidhje me një informatë të raportuar në media se zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës me dt. 26 dhjetor 2011, kanë pranuar të vendosin targa të Republikës së Serbisë mbi targa të Republikës së Kosovës.

Ministri Bjaram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Ganimete Musliu, parashtoi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj, në lidhje me atë se çfarë ka bërë Ministria e Punëve të Jashtme për iniciimin e procedurës për verifikimin e pronësisë së objekteve të trashëgimisë kulturore të Kosovës, të ndaluara në Ministrinë e Shkencës dhe Artit, në Landin e Hessenit në Gjermani.

Ministri Enver Hoxhaj, iu përgjigj pyetjes së deputetes Ganimete Musliu.

Deputeti Arsim Bajrami, parashtoi pyetje për zv.kryeministrin, Hajredin Kuçi, në lidhje me përgatitjen e doracakut të ri për dhënien e provimit të jurisposdencës, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Zv.kryeministri, Hajredin Kuçi, iu përgjigj pyetjes së deputetit, Arsim Bajrami.

Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, parashtoi pyetje për ministrin, Fehmi Mujota, në lidhje me jetësimin e projektit për rregullimin e rrugëve që lidhin fshatrat boshnjake në komunën e Prizrenit dhe Zaplluxhën në komunën e Dragashit, deri te qendra për skijim te vendi i quajtur Guri i Zi në malet e largëta të Dragashit.

Ministri Fehmi Mujota, iu përgjigj pyetjes së deputetes Afërdita Berisha-Shaqiri.

Deputeti Burim Ramadani, parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi, në lidhje me mos konfiskimin e targave të automjeteve të para vitit 1999, sikurse janë GL, PR, PZ e të ngjashme. Ministri Bajram Rexhepi, iu përgjigj pyetjes së deputetit, Burim Ramadani.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur me 20 dhjetor 2011

Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 20 dhe 23 dhjetor 2011, pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës, për mandat të ri

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratuar më 7 prill 2011 si dhe të vendimit të Kuvendit të datës 22 prill 2011, ka kërkuar nga Kuvendi mandat të ri, me qëllim të amendamentimit të nenit 84 të Kushtetutës, që përcakton kompetencat e presidentit të Republikës së Kosovës.

Ai më tej theksoi se ky komision ka shprehur gatishmërinë për rishikimin e dispozitave kalimtare të Kushtetutës që ndërlidhen me pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës.

Kryetari tha se ndërkohë, edhe Grupi prej 32 deputetëve ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës për amendamentimin e nenit 84 Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që ta arsyetojë kërkesën.

Deputeti **Arsim Bajrami** tha se Komisioni ka vlerësuar se ndryshimi i nenit 84 është i domosdoshëm për të kompletuar reformën kushtetuese. Kjo reformë nuk do të ishte e plotë sikur të mos rregullohej ky nen sepse ndryshon raporti i mënyrës së zgjedhjes së drejtpërdrejtë të presidentit në lidhje me qytetarët, me Kuvendin, me Qeverinë dhe me institucionet tjera shtetërore.

Ai më tej theksoi se pakoja e amendamenteve të propozuara deri më tani nga Komisioni që ai udhëheq është duke u shqyrtuar në Komisionin e Venecias.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë kërkesë dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Vjosa Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavleviq dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Sabri Hamiti, Arsim Bajrami dhe Hydajet Hyseni, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim kërkesën e Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për mandat të ri.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 62,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 1.

Kuvendi miratoi kërkesën e lartpërmendur të Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës i lejohet mandati i ri, në afat kohor prej dy muajve, që ka të bëjë me amendamentimin e nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin përcaktohen kompetencat e presidentit të Republikës së Kosovës.

5. Ratifikimi i Marrëveshjes financiare në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim KfW, për përmirësimin e sistemeve të ngrohtores qendrore

Kryetari i njoftoi deputetët se me kërkesë të Qeverisë së Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit që të bëjë Ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim KfW për përmirësimin e Sistemeve të Ngrohtores Qendrore.

Kryetari në vazhdim hodhi në votim ratifikimin e Marrëveshjes financiare. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 87,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi

V E N D O S I

1. Ratifikohet Marrëveshja financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim KfW për përmirësimin e sistemeve të ngrohtores qendrore.
2. Marrëveshja i dërgohet Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës, për publikim.

6. Debat lidhur me mocionin e GP të PDK-së për ngjarjet e 14 janarit 2012

Kryetari ftoi kryetarin e GP të PDK-së që ta arsyetojë mocionin.

Adem Grabovci tha se organizimi i protestë të lëvizjes “Vetëvendosje” më 14 janar 2012 është i papranueshëm ngase rruga nuk është vendi ku duhet të zgjidhen problemet, të çfarëdo natyre qofshin ato. Populli ynë ka nevojë për shërim plagësh të vjetra e jo të hapë plagë të reja. Në vijim deputeti Grabovci theksoi se nuk duhet të shkëputemi nga rruga institucionale e zgjidhjes së problemeve, ngase duke respektuar institucionet shtetërore ne respektojmë vetveten, respektojmë shtetin tonë dhe respektojmë miqtë tanë të shumtë në arenën ndërkombëtare, të cilët na kanë përkrahur në vazhdimësi.

Më tej Adem Grabovci u fokusua në faktin se shumë shtete janë në procesin e njohjes së shtetit të Kosovës, në faktin tjetër se ne kemi pranuar dhe respektojmë shumë akte ndërkombëtare me theks në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, CEFTA-n dhe shumë konventa të tjera dhe se protesta e 14 janarit 2012, mund të ketë interferim të mundshëm jo të duhur për Republikën e Kosovës.

Ai në fund propozoi rekomandimet të miratohen në fund të këtij debati.

Ministri **Bajram Rexhepi**, paraqiti një njoftim lidhur me protestën e mbajtur më 14 janar 2012.

Ai tha se kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme ligjore lidhur me këtë protestë.

Subjekti politik “Vetëvendosje” nuk e ka lajmëruar Policinë e Kosovës për protestën, e që sipas anës ligjore ajo duhet të bëhet 72 orë mbajtjes së saj. Me këtë “Vetëvendosje” ka shkelur Ligjin për tubimet publike.

Policia e Kosovës ka përgatitur planin operativ për parandalimin e bllokimit të rrugëve dhe të pikave kufitare.

Më tej ministri Rexhepi u fokusua në aspekte të tjera që lidhen me planin operativ të Policisë së Kosovës lidhur me protestën e subjektit politik të Lëvizjes “Vetëvendosje”, më 14 janar 2012.

Në vazhdim kryetari hapi diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, tha se shpreh keqardhje për ngjarjet e ndodhura më 14 janar 2012.

LDK konsideron se mocioni i votuar në Kuvend, më 7 dhjetor 2011 e obligon Qeverinë për reciprocitet me Serbinë, ndërsa ky fakt nuk i jep të drejtë asnjë subjekti politik që të marrë drejtësinë në dorë, konstatoi deputeti Ismet Beqiri.

Visar Ymeri, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se pas votimit të mocionit më 7 dhjetor 2011, pati trysni për ta kthyer atë në rivotim. Qeveria ka deklaruar se mocioni i votuar më 7 dhjetor 2011 është opinion i Kuvendit të Kosovës, i cili nuk është obligativ për Qeverinë, konstatoi ai.

Në vijim deputeti Visar Ymeri tha se nëse do të votohet ky mocion i paraqitur nga GP i PDK-së, atëherë kjo konsiderohet një dobësim i rolit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Lëvizja “Vetëvendosje” do të organizojë protesta sa herë që interesi i vendit të dhunohet, ndërsa protestat në rrugë janë legjitime dhe të domosdoshme në një vend çfarë është Kosova, theksoi deputeti Visar Ymeri.

Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së, tha se nuk i konsideron ndonjë çudi ngjarjet e 14 janarit 2012.

Në vazhdim, deputeti Isufi tha se marrëveshjet e arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk janë duke u zbatuar, ndërkaq kjo është pasojë e faktit se Qeveria e Kosovës në bisedime me Serbinë kishte hyrë pa një platformë të qartë, pa agjendë dhe pa afate kohore. Ai kërkoi nga Qeveria e Kosovës që ta zbatojë çdo vendim që nxjerr Kuvendi i Kosovës, në raport me reciprocitetin me Serbinë.

Myzejene Selmani, në emër të GP të Koalicionit Kosova e Re, tha se konsideron se një debat i tillë do të duhej mbajtur menjëherë pas ngjarjeve të 14 janarit 2012.

Ajo kërkoi nga Lëvizja “Vetëvendosje” dhe nga Qeveria e Kosovës që të tejkalojnë petkun partiak dhe të vendosin në favor të shtetit të Kosovës.

Qeveria duhet të tregojë se deri ku mund të zbatohet reciprociteti me Serbinë, theksoi deputetja Myzejene Selmani.

Rasim Demiri, në emër të GP “6+”, tha se grupi parlamentar që ai përfaqëson përkrah aktivitetet e Qeverisë për zgjidhjen e problemeve dhe se këto aktivitete do të jenë në të mirë të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë: Arsim Bajrami, Arben Gashi, Alma Lama, Emin Gërbeshi, Ramiz Lladrovci, Teuta Sahatqija, Ganimete Musliu, Muhamet Mustafa, Behar Selimi, Rexhep Selimi, Nijazi Idrizi, Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Liburn Aliu, Albulena Haxhiu, Valbona Dibra, Halit Krasniqi, dhe kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, deputeti **Adem Grabovci** paraqiti tekstin e mocionit për miratim, të përbërë prej katër rekomandimeve.

Kryetari i Kuvendit kërkoi deklarin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me mocionin e GP të PDK-së.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, tha se nuk e mbështet mocionin e GP të PDK-së.

Visar Ymeri, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje” tha se rekomandimet e propozuara nga GP të PDK-së nuk janë rezultat i debatit të zhvilluar në mbledhjen e sotme dhe nuk e mbështet mocionin e GP të PDK-së.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, tha se nuk e mbështet mocionin e GP të PDK-së.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim mocionin me rekomandime të GP të PDK-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër----- 41,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës mirëpret marrëveshjet e arritura në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, përmes procesit të dialogut dhe mbështet zbatimin e tyre të tërësishëm.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore, të vendosë për masat përkatëse reciproke për mbarëvajtjen e procesit të dialogut dhe implementimin e konkluzioneve të arritura.
3. Qeveria obligohet t'i raportojë Kuvendit lidhur me mbarëvajtjen e procesit të dialogut dhe reciprocitetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij dhe shfuqizon të gjitha vendimet e Kuvendit në lidhje me këtë çështje.

Kryetari deklaroi të mbyllur punimet e mbledhjes së sotme në orën 18:25 minuta, për të vazhduar të hënë, më 23 janar 2012, në orën 14:00.

E hënë, më 23 janar 2012,

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Në fillim mbledhjen e drejtoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 75 deputetë dhe deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare.

Kuvendi i vazhdoi punimet me pikat e mbetura.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Zëvendëskryeministrja **Mimoza Kusari-Lila**, tha se hartimi dhe procedimi i mëtejshëm i këtij projektligji është në vijë të plotë me përkushtimin e Qeverisë për vendosjen e ligjshmërisë dhe drejtësisë në planin kombëtar të bujqësisë dhe zhvillimit rural, për përcaktimin e objektivave afatshkurtra dhe veprimet e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Më tej ajo tha se projektligji rregullon çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një strukture komplete gjithëpërfshirëse të bazuara në rregulloret bazë të BE-së, për politikën e përbashkët bujqësore, dhe në këtë kontekst përmendi disa sosh.

Më pas ajo u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, zëvendëskryeministrja i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe të në emër të Grupit

Parlamentar të PDK-së, Nait Hasani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Boban Todoroviq dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, si dhe deputetët, Valbona Dibra, Gëzim Kelmendi dhe Muhamet Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 71,
Kundër----- 8,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se lidhur me këtë projektligj, fjalën e ka kërkuar në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, zëvendëskryeministrja Mimoza Kusari-Lila.

Mimoza Kusari-Lila tha se në bazë të nenit 56.5 të Rregullores së Kuvendit, Qeveria e Kosovës kërkon që Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë, të tërhiqet nga procedura parlamentare, në mënyrë që të plotësohet më tej.

Kryesuesi kërkoi deklarinë e përfaqësuesve të grupeve parlamentare lidhur me këtë çështje.

Për këtë çështje në vijim u deklaruan: **Adem Grabovci**, në emër të GP të PDK-së, **Ismet Beqiri** në emër të GP të LDK-së, **Alma Lama** në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, **Ahmet Isufi**, në emër të GP të AAK-së, **Jeton Svirca** në emër të GP të Koalicionit Kosova e Re, **Sasha Millosavljeviq** emër të GP SLS, dhe **Rasim Demiri**, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre deklarimeve, kryesuesi hodhi në votim kërkesën e Qeverisë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 55,
Kundër-----10,
Abstenime----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë, tërhiqet nga procedura parlamentare.

9. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi kryetarin e Nënkomisionit për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit, deputetin, Armend Zemaj, që para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë dhe arsyetojë Projekt-rregulloren.

Deputeti **Armend Zemaj** tha se Nënkomisioni ka hartuar këtë projekt-rregullore, i mbështetur edhe nga partnerët, siç janë: OSBE, NDI, KDI. Projekt-Rregullorja i është parashtruar Kuvendit për miratim, në parim, dhe pastaj Nënkomisioni, në bazë të vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve, do ta përgatisë Projekt-Rregulloren në shqyrtim të dytë, për miratim.

Ai theksoi se qëllimi themelor i kësaj projekt-rregullore është organizimi dhe funksionimi i Kuvendit, i vendosur mbi parimet dhe praktikat më të mira të parlamentarizmit demokratik në rajon, Evropë dhe më gjerë.

Deputeti Armend Zemaj, më pas u fokusua në aspekte të tërësishme të projekt-rregullores, që kanë të bëjnë me: strukturimin, organizimin, risitë, etj

Në fund, deputeti Armend Zemaj i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projekt-Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projekt-rregullore dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Amir Ahmeti, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jasmina Zhivković dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Arsim Bajrami, Teuta Sahatqija, Albin Kurti, Emilija Rexhepi, Safete Hadergjonaj, Sadri Ferati, Jeton Svirca, Alma Lama, Hydajet Hyseni, Hamza Balje, Vesimir Saviç, Hykmete Bajrami, Nait Hasani, Halit Krasniqi, Fadil Demaku, Sala Berisha –Shala, Sabri Hamiti, Armend Zemaj dhe kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projekt-rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 92,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projekt-Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projekt-rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullimin e tokës

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për rregullimin e tokës.

Raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e arsyetoi kryetari i këtij Komisioni, Nait Hasani.

Pastaj, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Në fund, kryetar hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	81,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për rregullimin e tokës.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Policinë

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Policinë.

Raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Ahmet Isufi.

Pastaj, kryetari hodhi në votim amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe nga deputeti Rexhep Selimi.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36 (i riformuluar sipas propozimit të kryetarit të Komisionit funksional), 37, 38 (i riformuluar sipas propozimit të kryetarit të Komisionit Funksional), 39, 40, 41, 42, 43, 45, 46, 48, 49, 50, 51, 52 dhe 53.

Kuvendi nuk e miratoi amendamentin 44, të propozuar nga deputeti Rexhep Selimi, ndërsa Komisioni funksional i tërhoqi nga votimi amendamentet 26 dhe 47.

Pastaj, kryetar hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	80,
Kundër-----	2,
Abstenime-----	8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Policinë.

.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 16:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.